



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN
Këshilli Drejtues

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" duke u bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit nr. 04-V-621 dhe Rregullores nr. 01-179/A të datës 11.05.2022, shpall:

K O N K U R S
Për ndarjen e bursave universitare për vitin akademik 2021/22

Përfitues të bursës universitare do të jenë studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" të cilët i plotësojnë kriteret sipas rregullore nr. 01-197/A të datës 11.05.2022 si dhe dispozitave të këtij konkursi:

I. Kriteret për përfitim të bursës:

- Të jetë student i rregullt i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren;
- Të jetë student i vitit të dytë e më lartë;
- Të mos ketë vit të përsëritur të studimeve;
- Të ketë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve deri në afatin e shtatorit;
- Të ketë notën mesatare së paku:
 - Studentët e Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, niveli baçelor - 8.5.
 - Studentët e Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Edukimit dhe Fakultetit të Filologjisë, niveli baçelor - 9.0.
 - Studentët e Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, niveli master - 8.5.
 - Studentët e Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Edukimit dhe Fakultetit të Filologjisë, niveli master - 9.0.

II. Dokumentacioni për aplikim:

- Formulari i aplikimit;
- Formulari i deklaratës nën betim;
- Pasqyra e notave;
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Numrin e llogarisë bankare (personale).

III. Afati i aplikimit:

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në Administratën Qendrore, kati II, zyra nr. 532, në objektet e FSHJM-së dhe Administratës Qendrore. Afati për aplikim është prej datës 14.4.2023 deri më 28.4.2023.

IV. Shënim: Lartësia e bursës do të caktohet me një vendim të veçantë nga Këshilli Drejtues si parashihet edhe me dispozitat e nenit 3 të rregullores nr. 01-197. Pas përfundimit të procesit të konkursit rrjedhimisht publikimit të listës me kandidatët të cilët shpallen fitues si dhe përfundimit të afatit të ankesave, përfituesit ftohen për nënshkrimin e kontratës për bursë universitare të nënshkruar nga Rektori.

Formulari për aplikim dhe deklarata nën betim gjenden në faqen zyrtare të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren: <https://www.uni-prizren.com/>